



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INFORMIMIT PUBLIK
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 3002 / Prot.
13

Patos, më 02/10/2025

NJOFTIM

Dëgjesë publike me temë:

“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030”

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit me nr. 2896 prot., datë 23.09.2025, për realizimin e konsultimit publik.

Ju njoftojmë se:

Ditën e **Mërkurë** në datë **05.11.2025 ora 10³⁰**, në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak Patos do të organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak; kryetarë të fshatrave; grupe interesi; banorë të zonës; insitucione publike dhe jopublike; OJF; shoqëri civile; përfaqësues të bashkisë Patos, lidhur mbi dëgjesën publike me temë: **“Vlerësimi strategjik mjedisor mbi Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**.

Ky konsultim publik synon të njoh gupet e interesit me vlerësimin strategjik mjedisor (VSM) të zbatimit të Planit të mbetjeve, si dhe të marr mendimet dhe komentet mbi raportin paraprak të VSM të propozuara për përmirësimin e dokumentit drejt raportit final.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: info@bashkiapatos.gov.al.

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjesë publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

